



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

**Plani i Integruar i Ministrisë  
2008**

Shkurt 2008

## Mesazhi i Ministrit



Edhe gjatë vitit 2008, Ministria e Punëve të Jashtme, në zbatim të programit të Qeverisë për marrëdhëniet me jashtë, do të jetë tërësisht e angazhuar në përmbushjen e përgjegjësisë të saj në shërbim të integritetit të vendit në strukturat euro-atlantike, duke mbështetur por edhe duke tërhequr vëmendjen për të angazhuar maksimalisht institucionet e tjera shqiptare në plotësimin e standardeve integruese. Thelbi i punës së Ministrisë do të jetë angazhimi i plotë i strukturave dhe i energjive të Shërbimit të Jashtëm në shërbim të procesit të integritetit euroatlantik. Në mënyrë të veçantë, MPJ dhe strukturat e saj do të vazhdojnë dialogun politik intensiv me vendet anëtare të BE-së për të përfunduar procesin e ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit në një periudhë kohore sa më të shpejtë brenda këtij viti duke i hapur rrugën aplikimit për të përfituar statusin e vendit kandidat në BE. Në këtë kudër MPJ do të angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në dialogun e Vizave me BE-në.


Shpallja e Pavarësisë së Kosovës përbën një ngjarje historike. Procesi i njohjes së Republikës së Kosovës, për të cilin MPJ është angazhuar intensivisht, po ecën me një ritëm të kënaqshëm përkundërshtimeve të disa vendeve dhe efektit të tyre në hapësirën e ndikimit. Ashtu si edhe më parë, pjesa më e rëndësishme e komunitetit ndërkombëtar është plotësisht e ndërgjegjshme dhe tërësisht e angazhuar në domosdoshmërinë e mbështetjes së gjithanshme të shtetit të ri, si element thelbësor në favor të paqes dhe stabilitetit në rajon. Ministria do t'i ushtrojë maksimalisht përgjegjësitë e saj, do të vazhdojë të përdorë gjithë mjetet në dispozicion, në planin dypalësh dhe shumëpalësh, për të ndikuar në rritjen e vazhdueshme të numrin të vendeve që e njohin Republikën e Kosovës. Avancimi i marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe diplomatike, ekonomike, politike e kulturore me të gjitha vendet e rajonit, përfshirë, kur të krijohen kushtet edhe me Serbinë, do të vazhdojë të ketë të njëjtin kujdes si kontribut konkret në forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

MPJ do të ndjekë në mënyrë të pandërprerë procesin e finalizimit të përpjekjeve për marrjen e ftesës për tu pranuar në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Ashtu si edhe më parë, asnjë përpjekje nuk do të kursehet për ta bërë këtë vit një moment shkëmbimi intensiv me sekretariatit e Aleancës dhe vendet anëtare, në përputhje me angazhimet tona që do të rrjedhin nga marrja e ftesës deri në anëtarësimin e plotë në Aleancë.

MPJ do të vijojë ta vërë diplomacinë në shërbim të ekonomisë, burimeve dhe potencialeve të vendit, duke synuar tërheqjen e investimeve të huaja, paraqitjen reale dhe të përditësuar të mundësive ekonomike dhe turistike që ofron Shqipëria, duke bërë njëkohësisht të njohura vlerat kulturore që ofron vendi. Duke siguruar një prani më të mirë të vendit në organizatat ndërkombëtare, në nismat shumëpalëshe dhe aksionin ndërkombëtar në tërësi, Ministria e Punëve të Jashtme kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e rolit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, mundëson prezantimin më të mirë e më të gjerë të vendit dhe imazhit të tij në botë. Për këtë qëllim, përveç hapjes së tre përfaqësive të reja (Portugali, Estoni, Norvegji), MPJ do të hapë edhe dy qendrat e para kulturore jashtë vendit.

Në një botë gjithnjë e më të ndërvarur e që përballet me sfida të reja, kontributi i çdo vendi, pavarësisht nga madhësia, përbën një vlerë të shtuar në përpjekjet e përbashkëta për stabilitet,

paqe, siguri dhe mirëqenie në botë. Ministria e Punëve të Jashtme do të vazhdojë ti përmbahet këtij synimi duke e bërë Shqipërinë aktor të rëndësishëm në planin rajonal por edhe në atë european e më gjerë.

Ministri  
  
Lulzim Basha

## Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë .....	5
2	Dokumente strategjike të Ministrisë .....	6
3	Programet buxhetore të Ministrisë .....	7
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....	8
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë .....	11
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur.....	12
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian.....	17
Aneks 3	Aneks 3. Investimet publike .....	18
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj .....	19
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit .....	20

# 1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Punëve të Jashtme formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të shtetit shqiptar, në zbatim të programit të qeverisë. MPJ në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë partnerët ndërkombëtarë, pasqyron të gjitha zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson e mbrojnë interesat kombëtare, si dhe punon për interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së tyre. Shërbimi i jashtëm i Republikës së Shqipërisë synon rritjen e rolit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe ato rajonale, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në aktet ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Jashtme, në zbatim të programit të Qeverisë për marrëdhëniet me jashtë, ka për mision parësor realizimin e prioriteteve në fushën e marrëdhënieve me jashtë, që në esencë synojnë:

Integrimin e vendit në strukturat euro-atlantike;

Ndihmë të gjithanshme autoriteteve të Republikës së Kosovës në procesin e njohjes ndërkombëtare, në forcimin e institucioneve dhe zhvillimin e gjithanshëm të shtetit të ri, duke vendosur një partneritet të ngushtë, të përfshirë në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dy e shumëpalësh rajonal;

Mbështetja e zhvillimeve të drejta rajonale që kanë për qëllim sigurinë, paqen dhe qetësinë në rajon dhe mbrojtjen e interesave kombëtare të vendit duke avancuar marrëdhëniet diplomatike, ekonomike, politike e kulturore me të gjitha vendet e rajonit;

Vënien e diplomacisë në shërbim të ekonomisë dhe burimeve të vendit tonë duke synuar investime të huaja brenda vendit dhe reklamim më të madh të mundësive ekonomike, dhe turistike që ofron Shqipëria si dhe duke bërë të njohur vlerat kulturore që ofron vendi ynë;

Mbrojtjen e të drejtave të interesave të vendit dhe të shtetasve të saj jashtë vendit;

Forcimin e mëtejshëm të strukturave të Shërbimit të Jashtëm, zgjerimin dhe forcimin e pranisë diplomatike të vendit, ngritje në një nivel më të lartë të marrëdhënieve midis shteteve si bazë për zhvillimet në fusha të ndryshme me interes të përbashkët dhe interes të përgjithshëm;

Rritjen e rolit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, nismat shumëpalëshe dhe koalicionet ndërkombëtare duke synuar avancimin e rolit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, ngritjen e imazhit të vendit tonë në botë, përfshirjen në projekte shumëpalëshe që kanë për qëllim stabilitetin, paqen, sigurinë dhe mirëqenien në botë.

## 2 Dokumente strategjike të Ministrisë

### Strategjia sektoriale e marrëdhënieve me jashtë

#### Qëllimet

Politika e jashtme e Republikës së Shqipërisë është gjithnjë në shërbim të mbrojtjes dhe nxitjes së interesave të shtetit dhe të shtetasve dhe në këtë kuadër, është tërësisht në favor të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimit në NATO. Veprimtaria diplomatike mbështet, reflekton dhe pasqyron punën e qeverisë për kryerjen e reformave të gjithanshme e të thella të nevojshme për plotësimin e standardeve për integrimit euroatlantik.

Duke i shërbyer qëllimit të integrimit evropian, politika e jashtme shqiptare ka përparësi bashkëpunimin rajonal, dy dhe shumëpalësh. Në këtë kuadër është mbështetur krijimi i zonës rajonale të tregtisë së lirë; është marrë pjesë aktive në përgatitjen dhe mbështetjen e politikave të zhvillimit në rajon; është mbështetur lufta kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme e korrupsionit; janë ndjekur dhe përkrahur zhvillimet politike dhe ekonomike në vendet e rajonit që synojnë sigurinë dhe zhvillimin rajonal; është punuar intensivisht dhe vazhdojnë përpjekjet për lehtësimin e lëvizjes së lirë dhe liberalizimin e politikave konsullore. Të gjitha këto dimensione do të forcohen e zgjerohen më tej duke u konkretizuar.

Përparësi të padiskutueshme në rolin aktiv të Shqipërisë në rajon do të ketë angazhimi i vazhdueshëm energjik në favor të njohjes sa më të gjerë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, në funksion të ruajtjes dhe forcimit të stabilitetit në rajon, zhvillimit të harmonizuar të Kosovës dhe arritjes së standardeve demokratike në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Rritja e vazhdueshme e rolit dhe e pjesëmarrjes së vendit në aktivitete dhe veprimtari ndërkombëtare, dy e shumëpalëshe, me vende apo organizata ndërkombëtare, është një synim i përhershëm i politikës së jashtme, i cili ka ardhur duke u zgjeruar në përputhje me shkallën e zhvillimit të vendit. Në këtë mënyrë, aktiviteti diplomatik ndikon në zgjerimin e njohjes së vendit, përmirësimit të vazhdueshëm të imazhit të realitetit shqiptar me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e mundësive për investime si dhe në ndërtimin e marrëdhënieve më të ngushta me vendet e tjera, në një hapësirë gjithnjë e më të madhe.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet reformimit të sistemit të Shërbimit të Jashtëm dhe përmirësimi i shërbimit publik të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

## **3 Programet buxhetore të Ministrisë**

### **3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM**

Politika e këtij programi ka si synim integrimin sa më të shpejtë të Shqipërisë në BE dhe në NATO; mbështetjen e zhvillimeve pozitive rajonale me qëllim ruajtjen e sigurisë, paqes dhe qetësisë në rajon; mbrojtjen e interesave kombëtare të vendit dhe të shtetasve shqiptarë; zhvillimin me përparësi të marrëdhënieve dypalëshe, shumëpalëshe si dhe zhvillimin e diplomacisë ekonomike e kulturore.

### **3.2 PËRFAQËSIT DIPLOMATIKE DHE SHËRBIMI KONSULLOR**

Politika e këtij programi ka si synim të realizojë përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë në botë dhe të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e punës si dhe efikasitetin e aktivitetit të përfaqësive diplomatike shqiptare jashtë vendit. Shërbimi konsullor, si pjesë e qenësishme dhe e rëndësishme e aktivitetit me jashtë, njëkohësisht edhe një shërbim publik, duhet të reformohet gjerësisht në formë e përmbajtje për arritjen e nivelit të duhur për të qenë i aftë që të përballojë me sukses përgjegjësitë e veta. Baza e reformave të programit do të jetë përdorimi sa më i gjerë i Teknologjive të reja, në mënyrë të veçantë nëpërmjet informatizimit të shkëmbimit të informacionit dhe shërbimeve që i ofrohen publikut duke i dhënë kështu shërbimit konsullor mjetet e nevojshme të punës, duke i siguruar ritmin e përshtatshëm dhe një imazh modern bashkëkohor. Programi do të udhëhiqet dhe koordinohet në të gjitha fazat e zbatimit të tij nga detyrimet dhe aktivitetet PZMSA duke pasur parasysh se reformat për integrimin e vendit prekin gjerësisht shërbimin konsullor.

### **3.3 INTEGRIMI EVROPIAN DHE EURO-ATLANTIK**

Politika e këtij programi synon zbatimin e aktiviteteve të MPJ për marrjen e ftesës dhe në mënyrë të veçantë marrjen e gjithanshme të masave për konkretizimin e anëtarësimit të vendit në NATO. Programi synon gjithashtu përshtetimin e procesit të anëtarësimit në NATO, vijimësinë e suksesshme dhe konkrete në procesin e Stabilizim Asocimit për integrimin e Shqipërisë në BE.

### **3.4 PROMOVIMI I IMAZHIT DHE VLERAVE TË VENDIT**

Politika e këtij programi synon të përmirësojë imazhin e vendit dhe të shoqërisë shqiptare nëpërmjet promovimit, kryesisht jashtë vendit, të kulturës, vlerave dhe traditës së pasur shqiptare, rrënjëve të saj të hershme e të pashkëputura europiane, prezantimit të mundësive për investim e fitim në Shqipëri, burimeve natyrore, lehtësive të krijuara posaçërisht për thithjen e investimeve të huaja direkte dhe klimës tërheqëse e favorizuese për biznesin e huaj, stabilitetin politik, gjendjen e shëndoshë makroekonomike të vendit etj. Programi synon gjithashtu të bëjë sa më të njohur jashtë vendit strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe të potencialeve të këtij sektori, si një prej potencialeve të mëdha të zhvillimit të vendit.

## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

### 4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe përzgjedhje e stafit të kualifikuar sipas gradave të përfaqësive.
- Menaxhimi i burimeve financiare nëpërmjet një përdorimi efektiv të vlerave materiale dhe monetare.
- Përmirësimi i shërbimit të përfaqësimit diplomatik dhe zgjerimi i përfaqësimit të diplomacisë Shqiptare në 5 shtete të reja.

Produktet që do të ofrohen:

- 13 audite të realizuara në institucionet e varësisë.
- Përfaqësim diplomatik i përditësuar nëpërmjet ambasadave, misioneve dhe konsullatave.

### 4.2 PËRFAQËSITE DIPLOMATIKE DHE SHËRBIMI KONSULLOR

Objektivat e politikës

- Përbushja e detyrave që dalin nga PKZMSA dhe SKM.
- Modernizimi i shërbimit konsullor, për të arritur nivele bashkëkohore në shkëmbimin e informacioneve dhe për të përmirësuar standardet në shërbimet e ofruara.
- Thellimi i marrëdhënieve konsullore me partnerët e huaj dhe shtimi i numrit të vendeve me të cilat RSH ka marrëdhënie konsullore.

Produktet që do të ofrohen

- Zgjerimi i veprimtarisë së rrjetit konsullor të përfaqësimit duke shtuar takime dhe konsultime konsullore me 20%.
- Trajnimi konsullor i diplomatëve dhe funksionarëve.
- Përmirësimi i kushteve të 10 ambienteve ekzistuese të pritjes në MPJ dhe përfaqësi.
- Përmirësimi i normativave konsullore me synim lehtësimin e shërbimeve konsullore.
- Riorganizimi i Drejtorisë Konsullore dhe shtimi i stafit për përballimin e detyrave të reja.
- Ngritja e sallës operative pranë Drejtorisë Konsullore për përballimin e situatave emergjente.
- Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të konsujve të nderit për mbulimin e plotë gjeografik në vendet ku mungojnë përfaqësitë tona diplomatike-konsullore.

### 4.3 INTEGRIMI EUROPIAN DHE EURO-ATLANTIK

Objektivat e politikës

- Marrja e ftesës për anëtarësim në NATO deri në fund të vitit 2008 dhe përbushja e detyrimeve të anëtarësimit.

- Përshpejtimi i procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe krijimi i kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen dhe përvetësimin e standardeve evropiane.
- Njohja sa më e shpejtë e shtetit të Kosovës dhe integrimi i tij ndërkombëtar në shkallë të gjerë.
- Transformimi i imazhit të rajonit.
- Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Produktet që do të ofrohen

- Shqipëria merr ftesën për tu anëtarësuar në NATO, në Samitin e Bukureshtit;
- Rritet numri i vendeve që ratifikojnë marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe procesi përfundon brenda vitit 2008;
- Shqipëria parashtron kërkesën për të marrë statusin e vendit kandidat në BE

#### **4.4 PROMOVIM I IMAZHIT DHE VLERAVE TË VENDIT**

Objektivat e politikës:

- Zhvillimi i diplomacisë ekonomike në funksion të tërheqjes së investimeve të huaja në vend;
- Zhvillimi i diplomacisë kulturore nëpërmjet afirmimit të identitetit tonë kombëtar evropian dhe vlerave më të mira kombëtare në arenën ndërkombëtare;
- Realizim i politikave kombëtare për zhvillimin dhe mbështetjen e diasporës shqiptare në botë.

Produktet që do të ofrohen:

- Nënshkrime protokolle bilaterale të bashkëpunimit ekonomik dhe kulturor;
- Aktivitete promovuese për ekonominë, turizmin, kulturën dhe diasporën shqiptare;
- Blerje dhe shpërndarje materiale promovuese në të gjitha përfaqësitë shqiptare.

**Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milion Lek**

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subvencionet 603	Të tjera transferte korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familjare dhe individët 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	35	79	0	0	0	206	320
Përfaqsitë Diplomatike	50	1,100	0	136	0	346	1,632
Promovimi i imazhit të vlerave të vendit	55	33	0	0	0	31	119
Integrimi europian dhe euro-atlantik	85	67	0	0	0	4	156
<b>Total</b>	<b>225</b>	<b>1,279</b>	<b>0</b>	<b>136</b>	<b>0</b>	<b>587</b>	<b>2,227</b>

## 5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Protokolle bashkëpunimi ekonomik dhe kulturor të përfunduar	Nr.	7 protokolle bashkëpunimi
Aktivitete promovuese për ekonominë, turizmin, kulturën dhe diasporën	Nr.	5 aktivitete promovuese në Evropë
Blerje dhe shpërndarje materialesh promovuese	Nr.	200 cope albume të fotografit Alket Islami
Ratifikimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit		Përfundimi i procesit
Numri i përfaqësive të reja diplomatike të hapura	Nr.	3 (Portugali, Finlandë dhe Estoni)
Trajnimi i nëpunësve konsullorë	Nr.	15 punonjës
Hapja e dy Instituteve të Kulturës	Nr.	2
Trajnim i atasheve kulturorë	Nr.	Do te trajnohen 10 atashetë kulturore n,ë dhjetë përfaqësitë kryesore në Evropë dhe SHBA

## Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

1. Projektligji «Për ratifikimin e Marrëveshjes së ripranimit të personave pa autorizim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë»
2. Projektligji «Për ratifikimin e marrëveshjes së ripranimit të personave pa autorizim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës»
3. Projektligji «Për aderimin e RSH-së në Korporatën Islamike për Zhvillimin e Sektorit Privat»
4. Projektligji «Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë»
5. Projektligji «Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin financiar me Bankën Nordike të Investimeve (BNI).
6. Projektligji « Për ratifikimin e Konventës së Hagës për njohjen e zbatimit të vendimeve mbi detyrimin ushqimor».
7. Projektligji « Për ratifikimin Konventës së Hagës për njohjen e divorcit dhe ndarjes ligjore»
8. Projektligji «Për ratifikimin e Marrëveshjes mbi lehtësimin e lëshimit të vizave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës»
9. Projektligji «Për ratifikimin e Marrëveshjes mbi lehtësimin e lëshimit të vizave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë»
10. Projektligji «Për ratifikimin e Konventës së Hagës mbi procedurën civile»
11. Projektligji «Për ratifikimin e Konventës së Hagës mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja për çështjet civile dhe tregtare»
12. Projektvendimi «Për miratimin në parim të Marrëveshjes mbi lehtësimin e lëshimit të vizave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës»
13. Projektvendimi «Për miratimin në parim të Marrëveshjes mbi lehtësimin e lëshimit të vizave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë»
14. Projektvendim “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH-së dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit për bashkëpunimin ekonomik, tregtar”
15. Projektvendim “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH-së dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve”
16. Projektvendim “Për ratifikimin e marrëveshjes së Informacionit të klasifikuar ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH-së dhe Qeverisë së Bullgarisë”
17. Projektvendim “Për miratimin e marrëveshjes për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve me Kuvajtin”
18. Projektvendim “Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të ministrave të RSH-së dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit’
19. Projektvendim për hapjen e përfaqësisë së Republikës së Shqipërisë në Lisbonë, Portugali

20. Projektvendim për hapjen e përfaqësisë së Republikës së Shqipërisë në Oslo, Norvegji
21. Projektvendim për hapjen e përfaqësisë së Republikës së Shqipërisë në Talin, Estoni
22. Projekt-ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane mbi ekstradimin e 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për ndihmën juridike për çështjet penale e 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre”
23. Projekt-vendimi “Për një ndryshim në Vendimin nr. 152, datë 25.4.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 355, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”
24. Projekt-ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për disa çështje ekonomike dhe tatimore”
25. Projekt-ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes në fushën e punës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Protokollit Ekzekutiv të Marrëveshjes”
26. Projekt-vendim “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për njohjen e ndërsjellë për konvertimin e lejeve të drejtimit të automjeteve”.
27. Projekt-ligj “Për aderimin në Marrëveshjen mbi tregtinë me Avionët Civile”
28. Projekt-vendimi “Për miratimin e programit të bashkëpunimit kulturor dhe shkencor ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Qeverisë së Federatës Ruse për vitet 2007-2009”
29. Projekt-vendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së federatës Ruse për bashkëpunimin për luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike, dhe substancave psikotrope”.
30. Projekt-vendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës për mbrojtjen dhe Nxitjen e investimeve “.
31. Projekt-ligj “Për ratifikimin e Konventës së KE mbi moszbatueshmërinë e legjislacionit të brendshëm për krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës”.
32. Projekt-ligj “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin dhe parandalimin e evazionit fiskal”.
33. Projekt-ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës për ripranimin e personave”.
34. Projekt-vendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim në fushat e postave dhe komunikimeve elektronike”
35. Projekt-vendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunimin dhe asistencën e përbashkët në rast katastrofash dhe aksidentesh”

36. Projekt-vendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për rregullimin e lëvizjes së shtetasve ndërmjet dy vendeve”.
37. Projekt-ligji “Për ratifikimin e memorandumit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës së lartë për transformimin (HQ SACT” lidhur me masat mbështetëse të shtetit pritës për përmbushjen e operacioneve të NATO-s”
38. Projekt-ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Pjesëshme të Zgjeruar në Sport (EPAS)
39. Projekt-ligji ”Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Holandeze për Zhvillim (SNV)
40. Projekt-ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Metrit”
41. Projekt-ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes për asistencë ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për bashkëpunimin ndërkufitar”
42. Projekt-ligj “Për ratifikimin e Marrëveshjes për asistencë ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore në rast të katastrofave në zonat ndërkufitare”
43. Projekt-ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për bashkëpunimin financiar”.
44. Projekt-ligji “Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për shmangien e taksimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal”
45. Projektvendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin për zhvillim”.
46. Projektvendim “Për miratimin e përballimit të shpenzimeve të fëmijëve të nëpunësve të emëruar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja”
47. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Çekisë mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit”
48. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2002, në kuadër të projektit ‘Program për mbrojtjen e mjedisit të liqenit të Ohrit (Komponenti kanalizimet e ujërave të zeza, Pogradec II)”.
49. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Qeverisë së RF të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2002 mbi marrjen nga KFË, Frankfurt am Main një shumë prej 7.500.000 Euro për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Shkodrës”
50. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim për projektin “Furnizimi me ujë dhe mbrojtja e mjedisit të liqenit të Shkodrës”.

51. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KFË), për projektin “Mbrojtja e mjedisit të liqenit të Shkodrës”.
52. Projektvendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar, për programin për furnizimin me ujë të zonave rurale”
53. Projektvendimi “Për miratimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KFË, Frankfurt am Main për financimin e programit “Rezervati biosferik ndërkufitar i Prespës-mbështetja e parkut kombëtar të Prespës”.
54. Projektvendimi “Për miratimin e Marrëveshjes specifike mbi mbështetjen e një projekti për decentralizimin dhe qeverisjen vendore ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë”.
55. Projektligji “Për ratifikimin Marrëveshjes për transportin rrugor ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Qipros”.
56. Projektligji “Për ratifikimin Marrëveshjes për shërbimet ajrore ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës”.
57. Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Memorandumin e Mirëkuptimit për kontrollin shtetëror portual, duke përfshirë edhe amendamentin e adoptuar në 9 maj 2002”.
58. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Estonisë”.
59. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar”.
60. Projektvendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Qeverisë së Republikës Qipros për bashkëpunimin në fushën e turizmit”.
61. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për asocimin e Republikës së Shqipërisë në programin e shtatë kuadër të Bashkimit Evropian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet demonstrative (2007-2013)”
62. Projektvendimi për miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e turizmit ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit.
63. Projektvendimi për miratimin e Marrëveshjes fushën e Kulturës dhe artit ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit.
64. Projektligji për aderimin në Marrëveshjen Evropiane mbi Linjat e rëndësishme ndërkombëtare të transportit të kombinuar dhe instalimet përkatëse (AGTC).
65. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën mbi Taksimimin e Automjeteve Rrugore në Transportin Ndërkombëtar të Udhëtarëve”.
66. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën mbi trajtimin doganor të paletave të përdorura në transportin ndërkombëtar”

67. Projekt-ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Evropiane për zbatimin e nenit 23 të Konventës së vitit 1949 mbi trafikun rrugor, në lidhje me dimensionet dhe peshat e mjeteve që lejohen të udhëtojnë në rrugë të caktuara të palëve kontraktuese”
68. Projekt-ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën mbi Taksimin e Automjeteve Rrugore për përdorim privat në trafikun ndërkombëtar dhe protokollin e nënshkrimit”
69. Projekt-vendimi “Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maltës mbi nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve”.
70. Projekt-ligji “Për të huajt”.
71. Projekt-vendimi “Për vendimin Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve”.
72. Projektligji “ Për miratimin e Konventës së UN “ Mbi arrestimin e anijeve, 1989”.
73. Projektligji “Për miratimin e Konventës mbi pengjet dhe pretendimet detare”.
74. Aderimi në Konventën e Shitjes ndërkombëtare të Mallrave.
75. Projektligji “Për Aderimin në Protokollin e Konventës së vitit 1979 “Mbi ndotjen atmosferike ndërkufitare në distanca të mëdha, lidhur me kontrollin e shkarkimeve të oksideve të Azotit ose rrymave të tyre ndërkufitare”.
76. Projektligji “Për Aderimin në Protokollin e Konventës së vitit 1979 “Mbi ndotjen atmosferike ndërkufitare në distanca të mëdha, lidhur me pakësimin e shkarkimeve të squfurit ose të rrymave të tyre ndërkufitare, të paktën 30%”.

## Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian

- Miratimi i Projektligjit të ri “Për të huajt”.
- Miratimi i Urdhrit të Kryeministrit për prodhimin e pullës vizë.
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për të Huajt”
- Miratimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 8977, dt. 12.12.2002, “Për sistemin fiskal në RSH”, iniciative e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Rregulloren e KE, 454/2003, “Për tarifatat e vizave”.
- Miratimi i ndryshimeve të VKM, nr. 439, dt. 4.5.2000 “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH” në kuadër të hartimit të politikave të vizave në përputhje me politikatat e BE-së, në kuadër të rishikimit të listave pozitive dhe negative, dhe në kuadër të aplikimit të formularit për dokumentet e panjohura dhe formularit për vizat në grup”
- Organizimi i një Seminari informues lidhur me detyrimet që lindin nga nënshkrimi i Kartës së Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare, si dhe impakti i zbatimit të kësaj karte në vendin tonë.
- Miratimi i Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Jashtme “Për hartimin e listave të personave të shpallur ‘non grata’”.
- Ndryshimi i Urdhrit të Përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Brendshëm nr. 1460, date 21.5.2001 “Për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve”.
- Përfundimi i procedurave të brendshme ligjore për miratimin e “Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverive të Republikës së Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Moldavisë, Republikës së Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë për bashkëpunimin në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet iniciativës antikorrupsion të Evropës Juglindore”.
- Organizimi i moduleve të trajnimit të personelit që trajnon për çështjet e vizave.
- Zbatimi me rigorozitet i ligjit për auditimin dhe manuali rregullues për funksionin e sistemit të mbajtjes së llogarive: kontabiliteti, administrimi i vlerave materiale, monetare dhe inventare.
- Prodhimi dhe shpërndarja e vizave pullë.
- Për të gjitha prokurimet, siç është vepruar deri tani, do të përmirësohet zgjedhja e procedurës së hapur si procedurë më transparente, e cila lejon pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë; ndërsa zgjedhja e procedurës “kërkesë për propozim” do të bëhet vetëm për rastet të parashikuara në ligjin “Për prokurimet publike”.
- Përmirësimi i informacionit për të huajt dhe aksesit për të marrë informacion.
- Ngritja e Qendrës Kombëtare të Vizave (QKV).
- Mbajtja i regjistrit kombëtar të vizave në përbërje të QKV-së.
- Monitorimi i rregullave për funksionimin e sistemit konsullor në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore duke marrë masa për publikimin e tarifave, praktikave procedurale për veprimet konsullore, dokumentimin e veprimeve, funksionimin e rregullit të procedurave të arkiv-dokumentacionit, etj.
- Vijimi i auditimit në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, duke filluar me përfaqësitë më të mëdha (Athinë, Romë, Bruksel, Uashington, Selanik, Milano).

## Aneks 3 Aneks 3. Investimet publike

	<b>Ministria e Punëve të Jashtme</b>	<b>587,000</b>
	<b>Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi</b>	<b>206,200</b>
231	Rikonstruksioni i Hotel Dajtit	200,400
231	Blerje pajisje	5,800
	<b>Përfaqësitë Diplomatike dhe Konsullore</b>	<b>345,800</b>
231	Hapja e ambasadës në Slloveni dhe Indi	71,000
231	Blerje të ambasadave në Paris dhe Londër	100,000
231	Hapja e ambasadës në Portugali, Estoni, Norvegji dhe zyra e përfaqësisë Pakistan	20,400
231	Pajisje zyre dhe apartamentesh	35,000
231	Pajisje informatike për përfaqësitë diplomatike	42,000
231	Pajisje informatike për shërbimin konsullor	5,000
231	Blerje automjete të reja për përfaqësitë diplomatike	22,400
231	Ngritja e Qendrës së vizave në MPJ	50,000
	<b>Promovimi i imazhit dhe vlerave të vendit</b>	<b>31,000</b>
231	Pajisje informatike	2,000
231	Hapja e 3 ekspozitave në Paris, Londër, Berlin	7,000
231	Hapja e qendrave të kulturës shqiptare Athinë, Londër, Romë	5,000
231	Vendosje bustesh të Skënderbeut, nënë Terezës, Paris, Londër, Berlin	17,000
	<b>Integrimi European dhe Euro-Atlantik</b>	<b>4,000</b>
231	Pajisje zyre	4,000

## Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Gjatë këtij viti MPJ pritet të përfitojë nga një pjesë e një financimi të huaj, “Albania Culture & Development 2008”, program i ofruar nga Qeveria spanjolle nëpërmjet PNUD-it, mbi bashkëpunimin kulturor. MPJ pritet të përfitojë një shumë që ende nuk është e përcaktuar. Financimi do të shërbejë për të organizuar trajnimin e atasheve kulturore në disa prej përfaqësive kryesore në vendet perëndimore, zhvillimin e vizitave studimore për këtë qëllim, ndihmë për hapjen e qendrës kulturore në Itali.

## **Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit**

Zbatimi i Rregullores së përgatitur në MPJ për të parandaluar konfliktin e interesit, në përputhje me kërkesat e ligjit 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;

Plotësimi dhe dorëzimi në kohë i formularit për deklarimin e interesave, si zbatim i detyrimit që rrjedh nga ligji 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”;

Ushtrimi i auditeve financiare periodike në përfaqësi.